



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të mërkurën, më 12 nëntor, Trupi Gjykues njoftoi se ish gjenerali Uesli Klark (Wesley Clark), dëshmitari i Mbrojtjes që ishte planifikuar të fillonte dhënien e dëshmisë të martën, 18 nëntor, do të fillojë dëshminë të hënën, më 17 nëntor, në orën 12:00. Ai është dëshmitari i fundit që synon të thërrasë Mbrojtja. Pas dëshmisë, të mërkurën, më 19 nëntor, është planifikuar të mbahet një konferencë për ecurinë e çështjes. Seanca që fillimisht ishte caktuar të mbahej të premten, 21 nëntor, është anuluar.

Deri më sot kanë dhënë dëshmi gjashtë dëshmitarë të thirrur nga Mbrojtja e Thaçit. Dëshmitari i gjashtë, Majkëll Dërki (Michael Durkee), filloi dëshminë dje pasdite. Sipas informacionit që dha Mbrojtja, dëshmitari ishte këshilltar politik i komandantëve supremë të forcave aleate të NATO-s në Evropë gjatë periudhës përkatëse.

Më 10 nëntor, Paneli i Apelit lëshoi një vendim mbi Apelin e Përbashkët të Mbrojtjes kundër vendimit të Panelit të Apelit për të pranuar si prova deklaratat me shkrim dhe provat materiale shoqëruese të një dëshmitari, për të cilin Trupi Gjykues konstatoi se ndaj tij ishte ushtruar ndikim i palejueshëm, çka bëri që ai të mos jepte dëshmi.

Sipas rregullës 155, Trupi Gjykues mund të pranojë prova në formën e deklaratave me shkrim, në veçanti në qoftë se është bindur se mosparaqitja e personit ose mosdhënia e dëshmisë është ndikuar thelbësisht nga ndërhyrje të palejueshme, si kërcënim, frikësim, lëndim, ofrim parash, ose shtrëngim. Sipas rregullores, Trupi Gjykues duhet të vlerësojë gjithashtu nëse janë përmbushur kushte të tjera të caktuara, përfshirë që dëshmia e propozuar, ose një dëshmi e barasvlershme, me të nuk mund të merret ndryshe dhe se pranimi i provave me shkrim është në interes të drejtësisë.

Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjykues nuk gaboi që i pranoi provat dhe theksoi se duhet bërë dallimi midis vendimit të Trupit Gjykues për të pranuar provat me shkrim të dëshmitarit dhe vendimit të Trupit Gjykues për peshën që do t'u jepet atyre përfundimisht, që do të vlerësohet në fund të procesit të gjykimit bazuar në tërësinë e provave. Në veçanti, Paneli i Apelit rikujtoi se Rregullorja nuk i lejon Trupit Gjykues të bazojë verdiktin e fajësisë vetëm, ose në masë vendimtare, në provat e një dëshmitari që Mbrojtja nuk ka pasur mundësinë ta marrë në pyetje.

Po ashtu, më 10 nëntor, në një vendim tjetër, Paneli i Apelit hodhi poshtë Apelin e Mbrojtjes së Thaçit kundër vendimit të Trupit Gjykues për të mos pranuar pesë deklarata të mëparshme me shkrim, të cilat u paraqitën për pranim nga Mbrojtja gjatë marrjes në pyetje të një dëshmitari të thirrur nga Prokuroria. Vendimi u bazua

1





në parimin se deklaratat e dëshmitarëve mund të pranohen vetëm sipas procedurave të përcaktuara në rregullat 153 deri 155, përveç nëse pala kundërshtare pajtohet me pranimin e provave. Paneli i Apelit konstatoi se vendimi i Trupit Gjykses ishte në përputhje me kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara ose me jurisprudencën e tribunalëve penalë ndërkombëtarë.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, në lidhje me akuza për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 11 nëntor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake njoftoi Kryetaren e Dhomave të Specializuara se çështja do të jetë gati për t'iu kaluar një trupi gjykses më 12 nëntor.

Më 12 nëntor, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendafilova, caktoi gjykatësin Kristofer Gosnell si Gjykatës të Vetëm në atë gjykim. Kryetarja theksoi se sipas nenit 25 të Ligjit, akuzat kundër të gjithë të akuzuarve në këtë çështje nuk cilësohen si krime të rënda, sikurse përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, dhe se, për këtë arsye, trupi gjykses mund të përbëhet prej vetëm një gjykatësi. Kur caktoi gjykatësin Gosnell, ajo më tej mori parasysh kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, përfshirë përvojën dhe ekspertizën relevante, si dhe disponueshmërinë në këtë periudhë. Po më 12 nëntor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri kalimin zyrtar të dosjes së çështjes.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 7 nëntor, Gjykatësja e Procedurës Penale miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë në lidhje me materialin e sekuestruar në objektin e paraburgimit. Mbrojtësja e pavarur që u caktua për të vlerësuar nëse materiali në fjalë kishte përmbajtje ligjërisht të privilegjuar, kishte njoftuar Gjykatësen e Procedurës Paraprake dhe palët se nuk e njeh mjaftueshëm kontekstin e materialit për të vendosur nëse informacioni është i privilegjuar. Për këtë arsye, Prokuroria kërkoi që materiali të shqyrtohej nga vetë Gjykatësja e Procedurës Paraprake.

Në vendimin e saj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se në vend që materiali të shqyrtohej prej saj, detyra duhet t'i mbetet mbrojtëses së pavarur. Për t'i dhënë mbrojtëses së pavarur kontekstin e nevojshëm, ajo urdhëroi Mbrojtjen e Thaçit që të dorëzojë informacionin relevant. Ajo urdhëroi gjithashtu Administratoren që t'i japë mbrojtëses së pavarur qasje në informacion tjetër që lidhet me kontekstin. Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi mbrojtësen e pavarur ta dorëzojë raportin më së voni më 17 dhjetor.

Më 10 nëntor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi një kërkesë të Prokurorisë për t'i kërkuar mbrojtëses së pavarur të nxjerrë informacion shtesë nga telefoni i sekuestruar i z. Kuçi. Gjykatësja e Procedurës Paraprake theksoi se Mbrojtja e Kuçit nuk e kundërshtoi kërkesën dhe konstatoi se veprimi që kërkohet përfshihet në kuadër të kontrollimit dhe sekuestrimit të autorizuar më parë. Ajo urdhëroi mbrojtësen e pavarur të kryejë veprimin e kërkuar dhe t'i dorëzojë Prokurorisë rezultatet deri më 5 dhjetor 2025.





Gjithashtu më 10 nëntor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendosi të bënte të disponueshme për Prokurorinë listat me emrat e materialeve të sekuestruara në objektin e paraburgimit. Në disa raste, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e gjykoi të domosdoshme që emrat e tyre të redaktoheshin, për të parandaluar qasjen nga Prokuroria në informacion të privilegjuar. Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi Prokurorinë që kërkesa të tjera që mund të ketë për qasje në materialin e ruajtur, t'i dorëzojë brenda një jave dhe i kërkoi Mbrojtjes së Thaçit që të përgjigjet, nëse dëshiron, brenda një jave.

Krahas këtyre vendimeve, disa vendime që më parë ishin klasifikuar si konfidenciale, u bënë publike këtë javë dhe mund t'i gjeni në faqen e internetit të DHSK-së. Vendimet në fjalë kanë të bëjnë me kontrollime dhe sekuestime dhe me shqyrtimin e materialit të sekuestruar.

